



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.234, datë 16.09.2022

PËR

**“SHPALLJEN E VENDIT VAKANT PËR DREJTUES TË PROKURORISË SË
POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”**

Në përputhje me nenin 148/dh pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me nenin 15, pika 1, e ligjit Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” të ndryshuar, nenin 52 pikat 5, 6 dhe 7 të ligjit Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procedurave të ngritjes në detyrë për zgjedhjen e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Njoftimi i pozicionit vakant të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen menjëherë në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 16.09.2022.

KRYETARI

Alfred Balla

